



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK169/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 17/11

Parashtruesit

Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. Nr. 228/2007, të 13 majit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina, nga Prizreni, të cilat i përfaqëson avokati Naim Qelaj, nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010, me të cilin refuzohet ankesa ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 490/2006, të 16 majit 2007, në lidhje me vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme në fjalë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010, duke pohuar se me këtë vendim janë shkelur nenet 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu sikurse edhe neni 6 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është paraqitur në bazë të nenit 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenit 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 56 paragrafit 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës, më 14 shkurt 2011, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 mars 2011, Gjykata Kushtetuese njoftoi avokatin Naim Qelaj, Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe Gjykatën Komunale në Prizren se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010.
7. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 17/11 të 2 marsit 2010), gjyqtari Altay Suroy u emërua Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit nr. KSH. 17/11, u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. Dr. Ivan Čukalović dhe Prof. Dr. Iliriana Islami.
8. Më 31 mars 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka cekur se nuk kanë asgjë të re për të shtuar, dhe se mendimi i saj për objektin e çështjes është paraqitur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 4 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren në përgjigjen e saj për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ka cekur se nuk ka asgjë të re për të shtuar, dhe se mendimi i saj për objektin e çështjes është paraqitur në aktgjykimet të cilat tani janë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.
10. Më 13 prill 2011, avokati Naim Qelaj në shkresën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkoi përjashtimin e gjyqtarit Altay Suroy, sepse gjyqtari Suroy ka qenë avokat i palës kundërshtare në procedurën e rregullt gjyqësore.
11. Më 5 maj 2011, gjyqtari Altay Suroy, në bazë të nenit 18.1.3 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ka kërkuar përjashtimin nga ky rast.
12. Më 4 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese siguroi prova (fletëkthimin për pranimin e dokumenteve) se avokati i parashtruesit të kërkesës, Gani Tigani, e ka marrë

Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 228/2007, të datës 13 maj 2010, më 3 qershor 2010.

13. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 17/11 të 10 tetorit 2011), Gjyqtar i ri raportues u emërua gjyqtari Robert Carolan.
14. Pas regjistrimit të kërkesës, gjyqtari Altay Suroy nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të procedurës dhe ka kërkuar nga Gjykata që të përjashtohet nga shqyrtimi. Gjykata e miratoi kërkesën e tij.
15. Më 23 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. Dr. Ivan Čukalović dhe prof. Dr. Iliriana Islami i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

16. Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin P. nr. 671/89, të 21 janarit 1993, ka hedhur poshtë si të pabazuar kërkesë-padinë e paditësve B. K., Y. K., G. K., M. K., N. M. e lindur K. dhe M. D. e lindur K., me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se ata janë pronarët e shtëpisë me oborr në Prizren, në rrugën „Sheshi Lidhja e Prizrenit“, nr. 13, në ngastrën kadastrale nr. 1911, të arës së klasit të IV, me sipërfaqe 24,30 ari, dhe të arës së klasit të V, me sipërfaqe prej 50 ari, që të dyja në vendin e quajtur „Kamenicë“, ngastra kadastrale nr. 5190, me kërkesën që të paditurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina, e lindur Xhana, t’ua njohin paditësve të drejtën në paluajtshmëri dhe t’i lejojnë ata që të regjistrohen si pronarë.
17. Ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit P. nr. 671/89, të 21 janarit 1993, paditësit B. K., Y. K., G. K., M. K., N. M., e lindur K. dhe M. D., e lindur K., ushtruan padi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
18. Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac. nr. 658/93, të 30 dhjetorit 1993, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit P. nr. 671/89, të 21 janarit 1993, dhe aprovoi kërkesën e paditësve B. K., Y. K., G. K., M. K., N. M., e lindur K. dhe M. D., e lindur K., duke vërtetuar se në bazë të trashëgimisë ata janë pronarët e shtëpisë me oborr në Prizren, në rrugën „Sheshi Lidhja e Prizrenit“, Nr. 13, në ngastrën kadastrale Nr. 1911, të arës së klasit të IV me sipërfaqe prej 24,30 ari si dhe të arës së klasit të V me sipërfaqe prej 50 ari, që të dyja në vendin e quajtur „Kamenica“, ngastra kadastrale nr. 5190, dhe urdhëroi që të paditurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina (Xhana) t’ua njohin paditësve të drejtën në pronën e paluajtshme dhe t’i lejojnë ata që të regjistrohen si pronarë në organet kompetente.
19. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 658/93, të 30 dhjetorit 1993, të paditurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina paraqesin dy mjete të jashtëzakonshme juridike: kërkesë për revizion dhe propozim për përsëritjen e procedurës.
20. Duke vendosur sipas kërkesës për revizion, Gjykata Supreme e Serbisë me aktvendimin Rev. nr. 5088/94, të 28 prillit 1995, hodhi poshtë si të papranueshëm revizionin ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 658/93, të 30 dhjetorit 1993.
21. Duke vendosur sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, Gjykata Komunale e Prizrenit me vendimin C. Nr. 248/94, të 6 marsit, refuzon propozimin për përsëritje të procedurës si të pabazuar.

22. Ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr. 248/94, të 6 marsit 2006, të paditurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina ushtrojnë ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
23. Gjykata e Qarkut në Prizren me aktvendimin Ac. nr. 490/2006, të 16 majit 2007, ndryshon arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit C. nr. 248/94, të 6 marsit 2006, ndërsa propozimin për përsëritjen e procedurës e hedh poshtë si të paafatshëm.
24. Ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 490/2006, të 16 majit 2007, të paditurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina parashtrojnë revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
25. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010, refuzon si të pabazuar revizionin ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 490/2006, të 16 majit 2007.
26. Më 3 korrik 2010, avokati Gani Tigani, i cili ka përfaqësuar të pandehurit (këtu parashtruesit e kërkesës) Shefkat Predibuka dhe Suhejla Morina, e mori Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010 (provë: fletëkthimi nga Gjykatës Supreme e Kosovës).
27. Në shkresat e lëndës gjendet edhe deklarata e avokatit Gani Tigani se, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev. nr. 228/2007, i datës 13 maj 2010, u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës me vonesë "rreth 1 nëntorit të vitit 2010" (shkresat e lëndës, faqja e shënuar me nr. 49).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pohon se me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev. nr. 228/2007, të 13 majit 2010, me të cilin refuzohet ankesa ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 490/2006, të 16 majit 2007, në lidhje me vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë, është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe atë nenet 24 (Barazia para Ligjit), 31 (E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm) dhe 46 (Mbrojtja e pronës), sikurse edhe neni 6 i KEDNJ (E drejta për një proces të rregullt).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Për të qenë në gjendje që të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, të shtjelluara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
30. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit i cili parashikon si në vijim:

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.“

31. Nga dokumentet e paraqitura mund të konstatohet që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

32. Vendimi i fundit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 228/2007, i datës 13 maji 2010, e që parashtruesi i kërkesës e ka marrë përmes avokatit të tij Gani Tigani më 3 korrik 2010 (provë: fletëkthimi nga Gjykata Supreme e Kosovës), ndërsa parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 14 shkurt 2011. Kjo do të thotë se e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë pas afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
33. Nga kjo del se kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, me të cilin parashikohet: “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi.”

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese si dhe rregullat 36 (1b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani